

Llogaridhënia e institucioneve në Maqedoni: mes angazhimeve dhe rezultateve

Analiza Nr. 37

Shkup, Maqedoni
Dhjetor, 2015

Kjo analizë është pjesë e projektit:



Botuar nga:

Qendra për hulumtim dhe krijim të politikave

Cico Popovic 6-2/9, 1000, Shkup

Tel/fax: +389 3109932

www.crpm.org.mk | crpm@crpm.org.mk

Autore:

M-r. Aleksandar Cekov

Redaktore:

D-r. Marija Risteska

Përgaditje teknike dhe dizajn:

Produkcija Perspektiva

Shtypur nga:

MagnaSken

Dhjetor 2015

Shkup Maqedoni

Komentet dhe vërejtjet e juaja vlerësohen: crpm@crpm.org.mk

Ambasada britanike në Shkup ka bashkë-financuar përgaditjen e këtij botimi në kuadër të projektit të financuar nga Bashkimi europian „Avokim për qeveri të hapur: përcaktim i agjendës nga shoqëria civile dhe monitorim i plan veprimeve të vendeve”. Përmbatja e këtij publikimi nuk e pasqyron domosdoshmërisht qëndrimin apo mendimet e Ambasadës britanike në Shkup dhe Bashkimit europian.

Përmbajtja

1.	Hyrje.....	4
2.	Llogaridhënia e institucioneve në Maqedoni.....	6
2.1.	Transparenca dhe llogaridhënia buxhetore.....	6
2.2	Monitorim i rregullativave dhe raportim për politikat publike	10
2.3.	Transparenca buxhetore e Kuvendit dhe mbikqyrja parlamentare	11
2.4.	Perceptimi i qytetarëve për llogaridhënien e institucioneve	13
2.5.	Perceptimi i qytetarëve për llogaridhënien e institucioneve në nivel lokal.....	17
3.	Shqyrtim i zotimeve të PQH-së për llogaridhënie.....	19
4.	Përfundim	21
5.	Rekomandime	22

1. Hyrje

Llogaridhënia e institucioneve në nivel qendror dhe lokal mendohet si një nga elementet kyçe në funksionimin dhe zhvillimin e shoqërisë moderne demokratike. Si e tillë, një nga detyrat e para të komunitetit akademik është definimi i vetë konceptit me qëllim që të qartësohet kuptimi i tij dhe aplikimi praktik në shoqëri dhe vend. Megjithatë, siç ndodh shpesh me konceptet e shkencave shoqërore-politike, dhe llogaridhënia bën pjesë në grupin e koncepteve të ashtuquajtura „amorfe” të cilat e marrin formën në varrshmëri me atë se kush i analizon, për çfarë nevojash dhe me çfarë qëllime. Ajo që mund të reduktohet në emërues të përbashkët nga interpretimet e ndryshme të konceptit është se llogaridhënia paraqitet si nevojë për vlerësimin e marrëdhënieve mes mbajtësve të funksioneve publike ose organeve të udhëheqjes publike dhe kryerjes së detyrave, funksioneve dhe kompetencave që i nënshtrohen mbikqyrjes, urdhërave ose kërkesave për qasje në informacione ose arsyetim të punës së tyre.

Nga kjo që është thënë më lartë, mund të përfundojmë se llogaridhënia paraqet një lloj „koncepti-ombrellë” i cili i mbulon, gjegjësisht i përfshin, parimet e transparencës, përgjegjësisë, pjesëmarrjes, përgjigjësisë (responsivitetit) dhe integritetit në udhëheqjen publike. E kuptuar në këtë mënyrë, llogaridhënia afrohet më afër konceptit më të gjerë të qeverisjes së mirë, ku në fakt llogaridhënia është një nga parimet e qeverisjes së mirë. Përputhja me konceptin e qeverisjes së mirë, e cila është në veçanti karakteristike për punimet akademike të përfaqësuesëve të shkollës amerikane për shkenca politike, e reflekton rëndësinë e konceptit të llogaridhënies për përf forcimin e proceseve demokratike në vend përmes kontrollimit të institucioneve dhe përfaqësuesëve të qytetarëve gjatë kryerjes së funksioneve të tyre.

Në të vërtetë, koncepti i llogaridhënies përfshin faza të ndryshme që e plotësojnë njëra tjetrën (komplementare): *përgjigjësi* (përgjegjësi) dhe *zbatueshmëri* e sanksioneve mbi institucionet ose individ të cilët i thyjnë parimet e punës së ndershme, gjegjësisht ata që punojnë në mënyrë joefikase dhe nuk i realizojnë shërbimet e kërkuara ose të pritura. Përgjigjësia ka të bëjë me obligimin për të paraqitur haptazi të dhëna për punën e institucioneve ose organeve, me qëllim që të mund ta arsyetojnë punën e tyre në aspektin e efikasitetit dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara, përderisa zbatueshmëria ka të bëjë me mundësinë për të zbatuar sanksione për shkelësit e primeve të llogaridhënies.

Domethënë, në përmbledhje, llogaridhënia është mekanizëm i rëndësishëm për vlerësimin e efikasitetit aktual të institucioneve ose nëpunësve, përmes së cilës sigurohet efikasiteti në kryerjen e funksioneve publike, sigurimi i shërbimeve cilësore sipas parimit vlere-më-e-mirë-për-paratë, që nga ana tjetër e përforcon besimin e qytetarëve tek nëpunësit publik, duke dhënë garanci që interesat e tyre janë të përfaqësuara në mënyrë të përshtatshme dhe efikase që gjithashtu mundëson zhvillim të proceseve demokratike në vend.

Në vazhdim, në këtë analizë të shkurtët do të paraqiten rezultatet nga hulumtimi i kryer nga Qendra për hulumtim dhe krijim të politikave për implementimin e praktikave për qeverisje të mirë në nivel qendror dhe për matjen e perceptimit të qytetarëve lidhur me punën e institucioneve. Hulumtimi u ndërmor me qëllim që të krijohet Indeksi i qeverisjes së mirë në Maqedoni i cili bazohet në 133 indikatorë, të ndarë në 8 kategori të qeverisjes së mirë. Rezultatet e institucioneve më pas u krahasuan me perceptimin e

qytetarëve për punën e institucioneve nga pikëpamja e kërkesave, nevojave dhe pritjeve të tyre që u qartësuan nga anketa në teren me një mostër përfaqësuese prej 1101 të anketuar.

Për nevojat e kësaj analize, do të përqendrohemi në indikatorët të cilët e matin llogaridhënien e institucioneve, në veçanti për sa i përket transparencës dhe llogaridhënies buxhetore, monitorimit të rregullativave dhe raportim për politikën publike, transparencës së Kuvendit për publikun dhe mbikqyrjes parlamentare.

Më tej, llogaridhënia e institucioneve do të vendoset në kontekst të formave të ndryshme të llogaridhënies. Gjegjësisht, varrësisht se para kujt japin llogari institucionet, ose para kujt janë përgjegjës, llogaridhënia mund të jetë vertikale dhe horizontale. Tek llogaridhënia horizontale, institucionet janë përgjegjëse para organeve ose institucioneve tjera për punën e tyre, ndërsa llogaridhënia vertikale përbëhet nga mekanizma të cilat u mundësojnë qytetarëve, gazetarëve, organizatave të shoqërisë civile të kërkojnë përgjegjësi nga institucionet në nivel qendror. Tek llogaridhënia horizontale, përgjegjësia për punë të papëlqyeshme mund të jetë ligjore ose politike. Në përgjegjësinë politike, institucion kryesor është Kuvendi, ndërsa për përgjegjësinë ligjore kompetente është gjyqësori.

Në disa dekadat e fundit, gjithëmonë e më shumë popullaritet fiton llogaridhënia diagonale, ku qytetarëve j'u jepet mundësia të marrin pjesë në punën e organeve të cilat kërkojnë përgjegjësi horizontale të institucioneve.

2. Llogaridhënia e institucioneve në Maqedoni

2.1. Transparenca dhe llogaridhënia buxhetore

Transparenca dhe llogaridhënia buxhetore është kryesore për sigurimin e të dhënave për të hyrat, shpenzimet dhe kostot e planifikuara të institucioneve në nivel qendror. Prandaj, është e nevojshme që institucionet t'i publikojnë dhe t'i bëjnë të disponueshme për qytetarët informacionet kyçe që kanë të bëjnë me buxhetin dhe realizimin e tij. Duke u bazuar në informacionet për proceset buxhetore dhe mënyrën e shpenzimit të parave publike mund të vijmë deri tek informacioni se a udhëheqin në mënyrë të përshtatshme me resurset publike institucionet gjatë sigurimit të shërbimeve ose gjatë përmbushjes së nevojave të qytetarëve.

Në kuadër të hulumtimit, transparenca buxhetore u notua bazuar në 16 indikatorë, nga të cilat 8 ishin interpretuese dhe shërbyen për t'i kuptuar më mirë proceset buxhetore, ndërsa 8 të tjerat u notuan me 0 ose 1, varësisht nga ajo se a është plotësuar ose jo indikator.


Bazuar në këto indikatorë u notuan 19 institucione në nivel qendror (Qeveria, 15 ministri, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë, Fondi për sigurim shëndetësor dhe Fondi për sigurim pensional dhe invalidor në Maqedoni).

Në tabelën më poshtë janë paraqitur indikatorët që notohen, nga përmbushja e të cilëve mund të shihet deri në çfarë mase institucionet i aplikojnë praktikat për transparencë dhe llogaridhënie buxhetore. Rezultatet që institucionet i arritën u paraqitën si përqindje e numrit të përgjithshëm të pikave të cilat i kanë mbledhur ato me përmbushjen e indikatorëve.

	Indikatorë	Pika
1.	Institucioni e ka publikuar pjesën e vetë nga buxheti i miratuar për vitin aktual sidhe projekte për vitin e ardhëshëm në faqen e internetit.	1
2.	Institucioni e ka publikuar raportin financiar gjysmëvjetor për vitin aktual.	1
3.	Institucioni e ka publikuar raportin vjetor për vitin paraprak në faqen e internetit	1
4.	Në faqen e internetit të institucionit ekziston dokument i ashtuquajtur buxhet qytetar i destinuar për „publikun jo-ekspert”	1
5.	Në faqen e internetit të Ministrisë për financa ekziston „buxhet qytetar” i destinuar për publikun jo-ekspert.	1 (vetëm Ministria për Financa)
6.	Në faqen e internetit ekziston informacion për buxhetin e vitit aktual i cili e qartëson lidhjen mes pikave buxhetore dhe qëllimeve strategjike të Qeverisë	1
7.	Institucioni në ndonjë mënyrë e ka vërtetuar opinionin publik për vitin 2016	1
8.	Institucioni në ndonjë mënyrë e ka shqyrtuar çfarë qytetarët duan të dijnë për buxhetin dhe mënyrën se si shpenzohen mjetet nga ana e institucionit. Në çfarë mënyre është shqyrtuar mendimi i qytetarëve?	1
	Gjithësej (pikë):	8


Kështu, sipas llojit të institucioneve, rezultate më të mira në këtë kategori të qeverisjes së mirë kanë arritur të dy fondet që ishin përfshirë në këtë hulumtim, gjegjësisht Fondi për sigurim shëndetësor dhe Fondi për sigurim penzional dhe invalidor në Maqedoni me 36% të pikave të mundëshme në këtë kategori. Pastaj vijnë Qeveria dhe Kuvendi me nga 14% ndërsa rezultate më të dobëta kanë arritur ministratë, mesatarja e të cilave është 4%. Ndërsa për të gjitha institucionet, mesatarja është 17% e pikave të mundëshme.

Ajo që shqetëson edhe më shumë, përveç rezultateve të ulëta në këtë kategori janë dallimet e mëdha në shkallën e transparencës buxhetore mes vetë institucioneve. Grafiku më poshtë i paraqet rezultatet individuale për secilin institucion.



Nga ky grafik mund të shihet se ka një numër të madh të institucioneve që nuk kanë përmbyshur asnjë indikator. Këtu duhet të përmendet se në procesin e mbledhjes së të dhënave vetëm 4 institucione (Ministria e punëve të brendshme, Ministria e drejtësisë, Fondi për sigurim shëndetësor dhe Kuvendi) kanë dorëzuar të dhëna përmes pyetësorit që e kanë dërguar

hulumtuesit. Megjithatë, sa i përket cilësisë së informacioneve, asnjë nga pyetësorët nuk përmblente të dhëna të plota për proceset buxhetore.




Siç kemi thënë më lartë, përfshirja e qytetarëve në proceset buxhetore varret nga publikimi i informacioneve të sakta, të kuptueshme dhe në kohë nga institucionet. Nëngrupi i dytë i indikatorëve e noton disponueshmërinë e këtyre informacioneve në faqet zyrtare të internetit të këtyre institucioneve.

Sa i përket publikimit të pjesës së vete nga buxheti për vitin aktual, vetëm 13% e institucioneve e kanë përmbyshur këtë indikator.

Institucionet kanë rezultate më të dobëta tek indikator i që e noton publikimin e raporteve gjysmëvjetore financiare, ku përqindja e përmbyshjes është 8%. Përqindje të njëjtë të përmbyshjes prej 8% kemi edhe tek publikimi i raporteve vjetore financiare për vitin e kaluar. Sa i përket publikimit të të

ashtuquajturit buxhet qytetar, i cili përmban të dhëna në formë të kuptueshme për qytetarët, vetëm 5% e institucioneve të përfshira me këtë hulumtim e kanë publikuar buxhetin e tyre në këtë formë. Sipas të dhënave nga hulumtimi, Ministria e financave nuk ka publikuar buxhet qytetar në formë të kuptueshme për qytetarët.

Përcaktimi i opinionëve të qytetarëve është parakusht kyç për prioritetizimin e nevojave të qytetarëve. Nëpërmjet mekanizmave për kuptim të opinionit publik, institucionet do të mund në mënyrë me efikase t'i planifikojë mjetet e kufizuara financiare gjatë përmbushjes së nevojave të qytetarëve. Në të njëjtën kohë qëllimet që i ka caktuar institucioni do të fitonin legjitimitet nga ana e palëve të prekura. Megjithatë, mjete të tilla ka përdorur vetëm një




institucion në periudhën e mbuluar nga ky hulumtim. Prandaj, institucionet do të duhej të përcaktojnë mënyrë nëpërmjet të cilës më së miri mund ta marrin parasyshë opinionin qytetarë gjatë buxhetimit të aktiviteteve, mënyrë e cila do të përdoret çdoherë kur do të ketë mundësi për të. Sidoqoftë, institucionet ekzistojnë që më së miri t'i përmbushin nevojat e qytetarëve.

Sa i përket indikatorit për publikimin e informacioneve që e shpjegojnë lidhjen mes pikave buxhetore dhe qëllimeve strategjike, rezultatet e institucioneve janë diçka më të mira. Gjithësej 6 institucione kanë publikuar të dhëna të tilla, ose e shprehur me përqindje 32% e institucioneve që janë përfshirë nga ky hulumtim.

Me qëllim që të hulumtohet mendimi i qytetarëve për atë se çfarë do të donin të dinin ato për atë se si shpenzohen paratë e popullit, nga qytetarët u kërkua që t'i rradsisin këto informacione sipas rëndësisë për ato: Buxheti i institucionit dhe projektimi për vitin e ardhëshëm, raporte gjysmëvjetore financiare të institucionit, lidhja mes pikave buxhetore dhe qëllimeve strategjike të institucionit, anketim i mendimit të qytetarëve.

Sa i përket pyetjes së parë, për publikimin e pjesës së vet të buxhetit të institucionit, si të rëndësishme e kanë veçuar gjithësej 65.9% që njëkohësisht paraqet dhe përqindje më të lartë nga të gjitha informacionet e përmendura.

Pastaj vijojnë raportet financiare të institucionit me 59.8%, pastaj anketimi i mendimit të qytetarëve gjatë krijimit të buxhetit për vitin e ardhëshëm me 59.2%, lidhja mes pikave buxhetore dhe qëllimeve strategjike të institucionit me 54%. Është interesante se nga qytetarët e anketuar, publikimi i buxhetit qytetarë në formë të kuptueshme i destinuar për qytetarët jo-ekspert rradhitet i fundit në mes të këtyre informacioneve me 52.7%.



Prioritetizimi i këtij grupi informacionesh u realizua sipas dallimit mes përmbushjes së indikatorit dhe perceptimit të qytetarëve. Dallimi më i madh nënkupton prioritet në raport me informacionet e tjera.

Indikator	Përmbushje e indikatorit	Perceptim i qytetarëve	Prioritet për institucionet
Pjesën e vet të buxhetit dhe projekcion për vitin e ardhëshëm	13%	65,9	1
Raport gjysmëvjetor financiar	8%	59,8	2
Buxhet qytetar	5%	52,7	4
Lidhja mes pikave buxhetore dhe qëllimeve strategjike	32%	54,0	5
Anketim i mendimit për buxhetin e vitit të ardhëshëm	11%	59,3	3

2.2 Monitorim i rregullativave dhe raportim për politikat publike

Sa i përket llogaridhënies horizontale, element i rëndësishëm është dhe publikimi i raporteve për llogaridhënien e institucioneve të cilat janë përgaditur nga organet kompetente. Kështu, nëpërmjet raporteve të këtyre organeve, në rradhë të parë nga raporti i Entit shtetëror për revizion, sidhe raporteve të organeve të tjera të pavarura dhe të jashtme, qytetarët pranojnë informacione për efikasitetin e punës së institucioneve në nivel qendror. Gjithashtu, raportet e tilla janë të rëndësishme dhe për vetë institucionet sepse në bazë të këtyre raporteve dhe rekomandimeve që vijnë nga ato kanë mundësi ta përmirësojnë punën e tyre, sa i përket efikasitetit dhe menaxhimit kompetent të resurseve publike. Njëkohësisht, këto raporte kontribuojnë në masë të madhe drejt ngritjes së cilësisë së shërbimeve që institucionet i ofrojnë për qytetarët e tyre.


	Indikator	Pika
1	Në vitin 2015 institucioni ka dërguar në Qeveri së paku një raport për implementimin e politikave, programeve dhe ligjeve.	1
2	Raport i institucionit nga viti 2-14 për politikën, programet dhe ligjet e implementuara është i publikuar në faqen e internetit.	1
3	Në vitin 2015 institucioni ka dorëzuar raport vjetor deri tek Qeveria për punën në vitin 2014.	1
4	Institucioni ka vendosur në faqen e internetit raport vjetor për punën e vet për vitin 2014.	1
5	Gjatë vitit 2014 institucioni ka angazhuar së paku një vlerësim të jashtëm për ndonjë program ose politikë sektoriale.	1
6	Institucioni ka vendosur në faqen e internetit raport për vlerësim për vitin 2014	1
7	Qeveria ka Udhëzime ose dokument tjetër që e rregullon mënyrën e monitorimit dhe raportimit për punën e ministrive përkatëse.	1
8	Institucioni ka publikuar raport revizioni (auditimi) për vitin 2014 në faqen e vet të internetit.	1

Rezultat më të mirë në këtë kategori ka arritur Fondi për sigurim shëndetësor me 57% dhe pastaj vijon Ministria e drejtësisë me 29%, Ministria e punëve të brendshme me 14%. Ministrinë e tjera nuk kanë përmbushur asnjë indikator. Këtu duhet përmendur se shumica e ministrive nuk i kanë dërguar informacionet e kërkuara, dhe prandaj përqindja e ulët e përmbushjes është pjesërisht rezultat i përgjigjshmërisë së ulët të institucioneve.

Sa u përket indikatorëve veç e veç, vetëm një institucion ka dërgur raport për implementim të politikave, programeve ose ligjeve për vitin aktual 2015, ndërsa tre institucione kanë vendosur raport për implementim të politikave, programeve ose ligjeve në faqen e internetit, gjegjësisht 18%.

Praksa e angazhimit të vlerësimit (evaluimit) të jashtëm, sipas hulumtimit tonë, nuk është themeluar si pjesë e praktikave për qeverisje të mirë, që do të thotë se asnjë nga institucionet nuk ka porositur evaluim të jashtëm për programet dhe projektet e veta.

Ajo që është edhe më interesante është se asnjë nga institucionet nuk e ka publikuar raportin e revizionit (auditimit) për vitin 2014 në faqen e vet të internetit.



Sa i përket përgjigjshmërisë së institucioneve qendrore, qytetarët u pyetën a kanë kontaktuar ndonjëherë me ndonjë nga institucionet qendrore me kërkesë ose pyetje konkrete përmes telefonit ose postës elektronike, dhe nëse po, a e kanë pranuar shërbimin ose informacionin e pritur?

Nga qytetarët e anketuar 26.2% janë përgjigjur se kanë kontaktuar ndonjë institucion qendror, nga të cilët 69.2% janë përgjigjur se i kanë pranuar shërbimet dhe informacionet e pritura, 30.1% e atyre që i kanë kontaktuar institucionet qendrore nuk i kanë pranuar shërbimet ose informacionet e pritura dhe 0.7% nuk janë përgjigjur. Kjo do të thotë se, përafërsisht, çdo qytetarë i katërt ka qenë në kontakt me ndonjë nga institucionet në nivel qendror në ndonjë mënyrë, ndërsa çdo i treti nga ato nuk është i kënaqur nga informacioni ose shërbimi i pranuar. Edhe pse në shikim të parë rezultatet nga përgjigjshmëria e institucioneve qendrore janë në nivel të kënaqshëm, institucionet qendrore duhet ta risin efikasitetin e dhënies së shërbimeve dhe informacioneve për qytetarët.

2.3. Transparenca buxhetore e Kuvendit dhe mbikqyrja parlamentare

Duke e patur parasysh faktin se Kuvendi është institucioni kyç në llogaridhënien horizontale, ku përfaqësuesit e zgjedhur nga qytetarët kërkojnë përgjegjësi politike nga institucionet qendrore, në vijim të analizës do të paraqiten më detajisht rezultatet e Kuvendit për sa i përket transparencës dhe llogaridhënies buxhetore sidhe qasjes së hapur të Kuvendit ndaj qytetarëve dhe kryerjes së mbikqyrjes parlamentare mbi institucionet qendrore. Nëndërkohë, qasja e hapur e Kuvendit është e rëndësishme dhe për llogaridhënien vertikale, sepse përmes transparencës u mundësohet qytetarëve, medimeve dhe organizatave të shoqërisë civile të përfshihen në punën e Kuvendit nëpërmjet diskutimeve publike, komisioneve dhe mekanizmave tjerë që mundësojnë të kërkojnë përgjegjësi nga institucionet qendrore.

Në kategorinë transparenca buxhetore, Kuvendi i Republikës së Maqedonisë ka realizuar rezultate më të dobëta me 14% nga pikat e mundëshmenë krahasim me rezultatet në kategoritë tjera, meqë ky rezultat është larg nga mesatarja e Kuvendit me 40% dhe diçka mbi mesataren e rezultateve të realizuara nga të gjitha institucionet në këtë kategori që arrin 8%.

Që ta përmirësojë rezultatin në këtë kategori, Kuvendi i R.M. mund të përmbush një sër indikatorësh siç janë: publikimi i pjesës së vet të buxhetit në faqen e internetit, publikim i raporteve financiare gjysmëvjetore dhe vjetore në faqen e internetit, ta hulumtojë opinionin publik në lidhje me atë se çfarë qytetarët do të donin të dinin për mënyrën se si shpenzohen paratë nga institucioni, të publikohet buxhet qytetar i cili do të ishte në formë të kuptueshme për qytetarët me çka do ju mundësojë më lehtë ta kuptojnë lidhjen mes parave të shpenzuara dhe efekteve të arritura me aktivitetet e realizuara.

Rezultatet e Kuvendit në kategorinë *Qasje e Hapur e Kuvendit me qytetarët* arrijnë 43% të pikave të mundëshme në këtë kategori dhe ky rezultat është më i lartë nga mesatarja e Kuvendit në katër kategori që është 40%.

Sa u përket indikatorëve një nga një, në nënkategorinë për publikim të informacioneve në internet, Kuvendi ka publikuar informacione për përbërjen, kompetencat dhe fushëveprimin e Kuvendit dhe grupeve punuese, sidhe rezultatet e përmbledhura për çdo pikë në rend dite. Gjithashtu, për qytetarës është e disponueshme dhe bazë e azhuruar e akteve që Kuvendi i ka shqyrtuar dhe gjithashtu mund të gjenden dhe video-inçizime të seancave plenare dhe seancave të komisioneve dhe organeve tjera punuese.

Më tej, sa i përket publikimit të kontakt-informatave të deputetëve, qytetarët kanë qasje tek biografitë e shkurtëra dhe kontaktet e deputetëve aktual të Kuvendit, sidhe të deputetëve të mëparshëm të Kuvendit të RM.

Sipas të dhënave nga pyetësi që e plotësoi Instituti parlamentar në Kuvendin e RM dhe shërbimit analitik, gjatë vitit 2014 kanë realizuar 6 diskutime publike.

Sa u përket sesioneve të komisioneve të mbajtura pa pjesëmarrje publike, sipas nenit 2 nga regullorja e punës së Kuvendit, Komisioni për mbikqyrje të punës së Drejtorisë për siguri dhe kundërinteligjencë ka mbajtur një sesion. Përveç Komisionit për mbikqyrje të punës së Drejtorisë për siguri dhe kundërinteligjencë gjatë vitit të kaluar, seanca pa praninë e publikut kanë mbajtur dhe Agjencia për inteligjencë dhe Komisioni për mbikqyrje të implementimit të masës speciale për ndjekje të komunikimit nga Ministria e punëve të brendshme, Drejtoria e policisë financiare, Drejtoria e doganave dhe Ministria e mbrojtjes, ndërsa gjithë komisionet tjera punojnë me pjesëmarrje të publikut dhe inçizimet nga seancat e tyre janë të disponueshme për publikun dhe emitohen në kanalin televiziv të Kuvendit.

Kuvendi gjithashtu ofron mundësi për punë praktike dhe implementon programe tremujore për praktikant. Sipas përgjigjes në pyetësor që e dorëzoi Kuvendi, së shpejti duhet të fillohet me implementimin e programit për punë praktike dhe në Institutin parlamentar.

Krahasuar me kategoritë tjera, Kuvendi ka realizuar rezultate më të mira në kategorinë *mbikqyrja parlamentare* me përqindje të përmbushjes 60%, që realisht është rezultat i kënaqshëm duke e patur parasysh që janë përmbushur më shumë se gjysma e indikatorëve sidhe që ky rezultat është për 17% më i lartë se mesatarja e institucionet në që të katër kategoritë.

Në kuadër të kësaj kategorie është analizuar efikasiteti gjatë shqyrtimit të raporteve nga Qeveria, Avokati i popullit dhe Enti shtetëror për revision, sidhe a harton Kuvendi përfundime për raportet e institucioneve pasi kanë përfunduar diskutimet. Më tej, në bazë të indikatorëve është shqyrtuar se në çfarë mase shfrytëzohet mundësia e interpelancës nga deputetët dhe nëse në interpelancë janë përfshirë deputetë nga parti të ndryshme politike. Në fund është shikuar në çfarë mase deputetët e shfrytëzojnë mundësinë për parashtrim të pyetjeve parlamentare sidhe a janë të disponueshme në faqen e internetit të Kuvendit këto pyetje dhe përgjigje.

Sa u përket raporteve, raporti vjetor i Avokatit të popullit për nivelin e sigurisë, respektimit dhe përparimit të mbrojtjes së lirive dhe të drejtave të njeriut për vitin 2013 është shqyrtuar në senacën e shtatë të mbajtur me 2 korrik, 2014, ndërsa raporti vjetor për revizionet e ndërmarra dhe në përgjithësi për punën e Entit shtetëror për revizion në vitin 2013 është shqyrtuar në seancën e dymbëdhjetë të mbajtur më 3 shtator, 2014. Sa u përket përfundimeve, nga Kuvendi morrëm përgjigje se „në Komisionin për sisteme politike dhe marrëdhëniet mes komuniteteve i cili e shqyrton raportin e Avokatit të popullit mbahen diskutime thelbësore dhe jepen komente thelbësore në përfundime në lidhje me raportet”.

Sa u përket interpelancave, në vitin 2014 nuk është dorëzuar asnjë interpelancë për punën e ministrave ose ushtruesëve të tjerë të funksioneve publike.


Në vitin 2014 nga deputetët e Kuvendit të RM janë parashtruar gjithësej 150 pyetje parlamentare nga të cilat 149 kanë pranuar përgjigje dhe vetëm një pyetje e parashtruar nga deputeti Ramiz Merko nuk ka marrë përgjigje. Pyetjet parlamentare janë të postuara në faqen e internetit të Kuvendit të RM (<http://www.sobranie.mk/pratenicki-prashanja.nspx>) gjë që në masë të madhe kontribuon drejt notimit të punës së deputetëve nga ana e qytetarëve.

2.4. Perceptimi i qytetarëve për llogaridhënien e institucioneve

Në analizën më lartë mund të shihet kapaciteti dhe gatishmëria e institucioneve për llogaridhënie horizontale dhe diagonale nëpërmjet indikatorëve të cilët e masin dhënien dhe publikimin e informacioneve të domosdoshme. Që qytetarët dhe palët e interesuara të mund të kërkojnë llogari (në veçanti nga Qeveria dhe ministrat, sidhe ushtrimin e detyrës për llogaridhënie horizontale nga Kuvendi përmes mbikqyrjes parlamentare.

Në analizën më poshtë do të prezantohet kapaciteti i qytetarëve për përfshirje në proceset e kërkimit të përgjegjësisë dhe llogarisë nga institucionet duke u bazuar në anketën me mostër të përfaqësuar drejtë me 1101 të anketuar në periudhën shtator-tetor 2015.

Gjatë kërkesës për llogaridhënie dhe përgjegjësi nga institucionet, besimi i qytetarëve ndaj institucioneve në nivel qendror është një parakusht i rëndësishëm. Kështu, një nga pyetjet për qytetarët ishte ta shprehin besimin ndaj institucioneve në nivel qendror.




Siç është paraqitur në grafikun më lartë, qytetarët kanë më shumë besim në organizatat e shoqërisë civile meqë 34,2% janë shprehur se ju besojnë ose se ju besojnë shumë. Pastaj vijon Kryetari i vendit me perceptim pozitiv prej 26,1%, Qeveria me 24.4%, ndërsa me besim më të ulët është Komisioni shtetëror për parandalimit të korrupsionit me 10.9%.

Sa i përket Komisionit për parandalim të korrupsionit, ky organi është i rëndësishëm për llogaridhënien horizontale të institucioneve në nivel qendror, sepse sipas mandatit ka kompetenca ta mbikqyr punën e funksionerëve dhe nëpunësve të zgjedhur dhe emëruar për parandalim të korrupsionit, konfliktit të interesave dhe veprimeve të tjera të paligjshme. Megjithatë, besimi i ulët i qytetarëve ndaj këtij organi është indikator serioz se Komisioni shtetërorë për parandalim të korrupsionit do duhet të ndërmerr reforma dhe aktivitete të pershtatshme drejt ngritjes së efikasitetit të punës sidhe drejt rritjes së dukshmërisë së punës së këtij Komisioni. Ajo që gjithashtu është shqetësuese është dhe boshllëku i madh mes besimit, gjegjësisht mosbesimit, drejt këtij institucioni. Sipas këtyre rezultateve, për shembull, qytetarët kanë më shumë besim në partitë politike se sa në këtë organ i cili duhet ta mbikqyr dhe korrupsionin gjatë financimit të partive si fushë me rrezik më të lartë të korrupsionit dhe kjo seriozisht e dëmton legjitimitetin e këtij organi në kuadër të llogaridhënies horizontale.

Organizatat e shoqërisë civile, nga ana tjetër, gëzojnë besim shumë më të lartë nga qytetarët në krahasim me institucionet tjera, dhe më shumë inkurajues është fakti se nuk ka boshllëk shumë të madh mes përgjigjeve me mendim pozitiv dhe negativ, siç është rasti me mediumet. Kjo mund të jetë indikacion se organizatat e shoqërisë civile kanë legjitimitet më të lartë para qytetarëve se sa, për shembull, mediumet, kur bëhet fjalë për kërkim të llogarisë nga institucionet në nivel qendror në kuadër të llogaridhënies vertikale.


Ndërsa kur bëhet fjalë për atë se a kanë qytetarët kapacitet, gjegjësisht a kanë njohuri të mjaftueshme që të vlerësojnë nëse ndonjë vendim i qeverisë është i keq apo i mirë, rezultatet nga hulumtimi i opinionit publik në vitin 2015 paraqesin rritje drastike të besimit mes vet qytetarëve se posedojnë kapacitet dhe njohuri të mjaftueshme t'i notojnë politikat e qeverisë.




Përderisa në vitin 2013 25.8% e të anketuarëve, ndërsa në vitin 2014 33.8% janë pajtuar me konstatimin se qytetarët nuk kanë kapacitet të mjaftueshëm për t'i vlerësuar vendimet e qeverisë, në vitin 2015 kjo përqindje ka rënë drastikisht në vetëm 7.9%, që është ulje për 26.1%. Sa i përket kërkimit të përgjegjësisë dhe llogarisë nga institucionet qendrore, këto rezultate sugjerojnë se kapaciteti i

qytetarëve (gjegësisht, vetëbesimi i tyre) është rritur dukshëm gjatë viteve të fundit. Ky mund të jetë rezultat nga kriza politike në të cilën u gjend vendi, dhe që ka shkaktuar interesim dhe ndjekje më të afërt të ngjarjeve politike (që do të thotë ndërgjegjësim më i lartë). Kjo mund të jetë reflektuar në ngritjen e vetëbesimit të qytetarëve se munden në mënyrë të përshtatshme t'i vlerësojnë vendimet e qeverisë.

Ngritja e pritjeve për llogaridhënie nga Qeveria vertikalisht, mund të vërehet në grafikun më poshtë, ku janë paraqitur rezultatet nga pyetjen për atë se në çfarë mase qytetatët pajtohen me konstatimin se të gjitha informacionet për kontratat financiare, implementuese dhe teknike që financohen nga Qeveria duhet të jenë publike. Më shumë se gjysma e të anketuarëve, gjegësisht 58.5% plotësisht pajtohen ndërsa 21.5% kryesisht pajtohen me këtë konstatim. Gjithësej, kjo do të thotë se 80% e të anketuarëve pajtohen se këto informacione do të duheshin të jenë publike dhe të arritshme për qytetarët.




Sa i përket kërimit të llogaridhënies nga deputetët të cilët janë të zgjedhur nga qytetarët që t'i përfaqësojnë interesat e tyre në shtëpinë ligjdhënëse, pjesa më e madhe e qytetarëve nuk pajtohen se deputetët gjatë krijimit të politikave udhëhiqen nga intereset dhe nevojat e qytetarëve.



31.2% e të anketuarëve nuk pajtohen aspak me konstatimin se deputetët krijojnë politika në emër të qytetarëve, përkundrazi 24.6% të qytetarëve të cilët janë shprehur se nuk pajtohen me qëndrimin e lartëpërmendur. Ky mosbesim tek deputetët të cilët janë zgjedhur në zgjedhje të drejtëpërdrejta dhe të cilët legjitimitetin për të marrë vendime e marrin drejtpërdrejt nga qytetarët sjell deri tek përfundimi se

ekziston mosbesim i lartë për punën e tyre. Që të rritet besimi nga qytetarët, deputetët do duhej të jenë më të hapur dhe transparent në kryerjen e funksionit të tyre dhe më shpesh t'i konsultojnë qytetarët për çështjet që ata mendojnë se janë prioritare për ata dhe komunitetin e tyre.

Përveç që vullneti i qytetarëve shprehet në zgjedhje me zgjidhjen e përfaqësuesëve në shtëpinë ligjdhënëse, qytetarët vullnetin, kërkesat e tyre dhe prioritetet mundën t'i shprehin dhe përmes formave të demokracisë direkte siç janë referendumet, iniciativat, tubimet dhe protestat, etj. Në këtë mënyrë, qytetarët në mënyrë të drejtëpërdrejtë mundën të kërkojnë përgjegjësi dhe llogari nga nëpunësit, përfaqësuesit ose institucionet publike në formën vertikale të llogaridhënies.



Nga grafiku më lartë mund të shihet se në vitin 2015 përqindja e qytetarëve që kanë marrë pjesë në protesta ose tubime është më e lartë në krahasim me dy vitet paraprake dhe arrin 29% ose përafërsisht secili qytetar i tretë në shtet ka marrë pjesë në ndonjë formë proteste ose tubimi. Megjithatë, duhet të potencohet se këtu nuk është bërë dallim mes protestave qytetare, tubimeve dhe protesteve të organizuara nga partitë prandaj ka gjasa që në përgjigjet e qytetarëve bëjnë pjesë dhe këto të fundit. Edhe pse, dhe pjesëmarrja në protestat e organizuara nga parti politike është shprehje e qëndrimeve dhe mendimeve individuale në hapsirë publike, diskursi modern demokratik më shumë do e vlerësonte aktivizmin qytetar si forma më autentike të artikulimit dhe promovimit të llogaridhënies dhe përgjegjësisë vertikale.

Në vitin 2015 kishte mjaftë protesta dhe tubime të organizuara nga qytetarët, qëllimi i të cilëve ishte të shprehin pakënaqësi ndaj politikave të caktuara të qeverisë, para së gjithash me shëndetësinë, arsimin, drejtësinë sociale dhe të tjera. Sidoqoftë, duhet të përmendet dhe se paralelisht me këto tubime u organizuan dhe tubime treja nga qytetarë¹ që e shprehnin përkrahjen për politikën qeveritare.


¹ Sipas deklaratave të pjesëmarrësve, protestat u organizuan spontanish nga qytetarët ndërsa nga struktura të caktuara në shoqëri këto u vlerësuan si tubime të organizuara nga partia në qeveri VMRO-DPMNE. Akuzat mes VMRO-DPMNE dhe LSDM për organizimin në hije të secilit protest ose tubim më masovik është praksë e llojit të vet në Maqedoni, që ndikon në masivitetin e protestave përshkak të frigës ose etiketimit.

2.5. Perceptimi i qytetarëve për llogaridhënien e institucioneve në nivel lokal


Ashtu si edhe në nivel qendror, kërkimi i llogaridhënies dhe përgjegjësisë më të madhe në institucionet në nivel lokal nga qytetarët është i kushtëzuar me publikimin dhe disponueshmërinë e informatave në kohë, të sakta, të kuptueshme dhe të plota. Përmes ndërgjegjësimit më të lartë qytetarët mundën në mënyrë më efikase t'i shfrytëzojnë mekanizmat për llogaridhënie dhe përgjegjësi vertikale në nivel lokal me qëllim të përmirësimit të shërbimeve dhe përmbushjes më efikase të nevojave të komunitetit.

Ajo që është karakteristike për institucionet në nivel lokal është se qytetarët kontaktojnë me ato më shpesh në krahasim me institucionet në nivel qendror, prandaj zvogëlimi i boshllëkut mes angazhimeve deklarative dhe rezultateve tjera do duhej të jetë me rëndësi primare për qytetarët. Më tej, që qytetarët të kenë pasqyrë më të mirë për punën e institucioneve në nivel lokal, ata duhet t'i shfrytëzojnë mekanizmat që i kanë në dispozicion për kyçje më efikase në punën e organeve ku sillen vendime. Për më tepër, rendi demokratik dhe qeverisja e mirë kërkojnë përfshirje më të madhe të qytetarëve si element kyç për proceset demokratike.

Diskutimet publike lokale janë mundësi e shkëlqyer për qytetarët që t'i shprehin qëndrimet e tyre për çështje të caktuara me rëndësi për komunitetet lokale sidhe për tu diskutuar për prioritetet që qeveria lokale duhet t'i përmbush. Sa u përket diskutimeve në nivel lokal, shumica e qytetarëve që u anketuan i vlerësojnë ato si ngjarje që kanë ndikim në politikat lokale. Kështu, 32,1% „kryesisht pajtohen” me këtë konstatim, 18.5% „plotësisht pajtohen” ndërsa 29.8% „kryesisht nuk pajtohen” ose „aspak nuk pajtohen” me këtë konstatim.




Edhe pse më shumë se gjysma e qytetarëve mendojnë se diskutimet publike në nivel lokal kanë ndikim në politikat lokale, pak qytetarë i ndjekin seancat e kuvendit komunal edhe pse ato janë të hapura për publikun, dhe në veçanti është e theksuar në Ligjin për vetëqeverisje lokale se qytetarët nuk mund të përjashtohet nga diskutimet për buxhetin.



Nga grafiku më lartë mund të shihet se vetëm 5.6% e qytetarëve i ndjekin seancat e këshillit nga të cilët 4.5% këtë e bëjnë shpesh ndërsa aktivisht i ndjekin vetëm 1.1% e qytetarëve. Kësaj mund t'i shtohen dhe 6.5% e qytetarëve të cilët këtë e bëjnë ndonjëherë. 8.4% e qytetarëve u përgjigjën se asnjëherë nuk i ndjekin, ndërsa pjesa tjetër prej 79% nuk kanë dhënë asnjë përgjigje.

Shumë e vogël është dhe përqindja e qytetarëve që e kontrollojnë buxhetin e komunës, i cili është i disponueshëm, gjegjësisht do duhej të ishte i disponueshëm kur kërkohet nga qytetarët ose në faqen e internetit të komunës.



Përqindja e ulët e qytetarëve që e kontrollojnë buxhetin e komunave, kryesisht ka të bëjë me faktin që numër i vogël i qytetarëve i kuptojnë ato ose kuptojnë si t'i ndajnë pikat buxhetore në „detin” e tabelave dhe numrave në këto dokumente. Hulumtimi LOTOS që u implementua gjatë vitit 2014 mësoi se në komunat të cilat përgadisnin të ashtuquajtur „buxhet qytetar” që në mënyrë më të thjeshtësuar i publikojnë dhe i paraqesin pikat buxhetore, qytetarët më shpesh i kontrollojnë të hyrat dhe shpenzimet buxhetore. Publikimi i informacioneve për lidhjen mes qëllimeve të vendosura dhe shpenzimeve buxhetore do ishte një praktikë tjetër e mirë. Ky ndërgjegjësim i qytetarëve është kyç që të mund të ndiqet shpenzimi i parave më tej dhe në veçanti që të kërkohet llogari nga institucionet për shfrytëzimin e parave për përmbushjen e qëllimeve të caktuara.

3. Shqyrtim i zotimeve të PQH-së për llogaridhënie

Partneriteti për qeverisje të hapur (PQH) është iniciativë e rëndësishme globale, ndikimi i së cilës në zhvillimet nacionale drejt qeverisjes së mirë në Maqedoni gjithashtu rriteti. PQH është, mbi të gjitha, platforma ku shoqëria civile dhe nëpunësit shtetëror në mënyrë të hapur i diskutojnë nevojat e institucioneve dhe kapacitetet e tyre për ta përmirësuar situatën. Pronësia dhe përgjegjësia e ndërsjellë që iniciativa PQH e ka sjell në mes të institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile është një nga përfitimet kryesore nga PQH në Maqedoni. Kjo është në veçanti e vërtetë meqë shumica e masave të plan veprimit për PQH 2014-2016 nuk janë origjinale dhe janë të kopjuara nga dokumente tjera strategjike të qeverisë, megjithatë, ky nuk është rasti me masat e prioritetit *menaxhim efikas i burimeve publike (transparenca fiskale)*. Ky prioritet ka shtatë masa gjithësej dhe që të gjitha janë hartuar me bashkëpunim të afërt mes institucioneve shtetërore dhe shoqërisë civile. Shoqëria civile gjithashtu është kyçur afërsisht në procesin e implementimit të masave. Edhe pse shkalla e implementimit të masave në këtë prioritet është e ulët, është me rëndësi të potencohet se ata janë më origjinale se masat mesatare të këtij plan veprimi dhe implementimi i tyre nuk varret në masë të madhe nga financim, por më shumë ng vullneti dhe interesimi i palëve implementuese. Këtu do të ofrojmë një shqyrtim të shkurtër për atë se çka është arritur brenda këtij prioriteti deri më tani dhe nëse këto në ndonjë mënyrë kontribuojnë në llogaridhënien e institucioneve.

Prioriteti: Menaxhimi efikas i burimeve publike (transparenca fiskale)	
Masa	Niveli i kompletimit
3.1.a Ministria e financave publikon buxhet vjetor në format të hapur.	E kompletuar
3.1.b Ministria e financave publikon buxhet vjetor si „buxhet qytetar”.	Pjesërisht
3.1.c Ministria e shëndetësisë do e konsiderojë mundësinë për të publikuar të dhëna për implementimin e programeve shëndetësore (financiar dhe narativ).	Pjesërisht
3.2.a Të publikohen plane vjetore për prokurime publike, kontrata të nënshkruara dhe informacione për implementimin e kontratave të nënshkruara për prokurim publik.	Pjesërisht
3.2.b Të caktohen dhe implementohen standarde për transparencë me një listë të informacioneve minimale që secili institucion që kryen prokurime publike duhet ta publikojë në faqen e internetit.	?
3.3.a Të publikohen dokumente për investime të huaja në Maqedoni	Nuk është filluar
3.3.b Të publikohen të dhëna për ndihmën e jashtme të planifikuar dhe të pranuar	Nuk është filluar

Ministria e financave ka publikuar buxhet në format të hapur (xml) për disa vite me radhë. Megjithatë, si pasojë e zotimit të parë në këtë prioritet Ministria e financave gjithashtu ka publikuar ndryshimet që janë bërë në buxhet në format të njejtë (XML) përveç se në format PDF, dhe ai mund të gjendet në portalin www.otvorenipodatoci.gov.mk. Gjithashtu, kjo ministri ka publikuar dhe version të plotë të llogarisë përfundimtare të Buxhetit të Republikës së Maqedonisë për 2014. Megjithatë, puna nuk ka qenë aq efektive në publikimin e buxhetit të parë qytetarë në Maqedoni. Sipas Ministrisë së financave, aktivitetet për këtë zotim janë në proces dhe është ndërmarrë prokurim publik për të angazhuar kompaninë që do e krijojë atë.

Në anën tjetër, me kërkesë të një organizate të shoqërisë civile Ministri e shëndetësisë është pajtuar të bashkëpunojë dhe të publikojë të dhëna për implementimin e programeve të veta preventive dhe

kurative. Hapi i fundit i arritur për të cilin është raportuar deri më tani është se ka patur një marrëveshje që Ministria e shëndetësisë do të hartojë një raport për secilin program dhe se këto raporte do të shqyrtohen së bashku me organizatën e shoqërisë civile, mirëpo ky takim ende nuk është realizuar.

Tre masat e radhës bien nën zotimin e njejtë: përmirësimi i procesit të prokurimit publik. Këto masa gjithashtu implementohen në bashkëpunim të ngushtë me shoqërinë civile, në fakt, si aktivitete të projekteve të një organizate lokale të shoqërisë civile që është munduar t'a rrënjos praktikën e mirë të publikimit të dokumenteve të rëndësishme për procesin e prokurimit publik nëpërmjet Zyrës për prokurim publik. Këto dokumente që pritet të publikohen në faqet e internetit të institucioneve përfshijnë plane për prokurim publik, marrëveshje të përfunduara për prokurim publik dhe raportim për marrëveshjet për prokurim publik që janë ekzekutuar. Raporti i vetëvlerësimit për implementimin e plan veprimit për PQH 2014-2016 gjatë vitit të parë vlerëson se kjo masë është kompletuar në masë të madhe, por monitorimi i CRPM tregon që vetëm një nga institucionet në hulumtimin tonë ka publikuar plan për prokurim publik në faqen e vetë të internetit ndërsa gjithë këto dokumente mungojnë nga faqet e internetit të të gjitha faqeve të internetit të analizuara. Kjo organizatë e shoqërisë civile gjithashtu ka për qëllim të iniciojë bashkë-krijimin e një liste me informacione minimale që institucionet duhet ta publikojnë në faqen e tyre të internetit por nuk ka raporte për atë se a ka filluar ky aktivitet. Kjo na shpie tek një nga mangësitë kryesore të metodave të raportimit të institucioneve shtetërore në vend: përderisa ato shpesh herë detajisht i shpjegojnë aktivitetet e kryera me sukses, nuk i përmendin aspak sfidat gjatë implementimit, mësimet e dala nga këto përvoja, dhe aq më pak aktivitetet që nuk janë filluar.

Niveli i implementimit të këtij prioriteti, në rastin më të mirë, është i kufizuar dhe një dobësi e rëndësishme që i gjithë procesi e ka zbuluar është se stagnimi i implementimit të masave nuk shkaktohet nga arsye financiare por nga keq-koordinimi i palëve implementuese dhe ndoshta edhe nga mungesa e angazhimit të sinqertë për t'i realizuar ato. Është një efekt anësor pozitiv që këta masa të përmendura kanë inkurajuar komunikimin mes organizatave të shoqërisë civile dhe institucioneve dhe nuk është raportuar për ndonjë kundërshtim për të bashkëpunuar. Shpresojmë se implementimi i këtyre masave të rëndësishme dhe të prekshme do të përparojë deri në përfundim të periudhës për implementim të plan veprimit ose, në rastin më të keq, do të implementohen në plan veprimin e ardhëshëm për PQH 2016-18.

4. Përfundim

Edhe pse ekziston përparim i dukshëm në lidhje me transparencën dhe qasjen e hapur të institucioneve në nivel qendror dhe lokal në Maqedoni të cilat i ka vënë në dukje Qendra për hulumtim dhe krijim të politikave², kjo nuk mund të thuhet për llogaridhënien e institucioneve. Sërisht, duhet të theksohet se përparimi i tillë mbi të gjitha ka të bëjë me Ligjin për qasje të lirë të informacioneve me karakter publik i cili i hapi dyert e institucioneve për qytetarët. Megjithatë, që puna e institucioneve të vlerësohet në të vërtetë, është e nevojshme që ata të jenë më llogaridhënës para qytetarëve në lidhje me efikasitetin gjatë përmbushjes së qëllimeve dhe prioritetëve të caktuara paraprakisht. Me fjalë tjera, institucionet duhet të punojnë në pajtueshmëri me parimin „vlera më e mirë për paratë” dhe t’i informojnë qytetarët për secilën fazë të procesit të implementimit të politikave publike. Më tej, shfrytëzimi efikas i mekanizmave për llogaridhënie dhe përgjegjësi nga ana e qytetarëve kërkon publikim të informacioneve në kohë, të sakta dhe të plota nga ana e institucioneve.

Transparenca dhe llogaridhënia buxhetore është një nga kategoritë ku institucionet në nivel qendror kanë arritur rezultate më të dobëta. Gjegjësisht, mesatarja e gjithë institucioneve në këtë kategori të qeverisjes së mirë arrin 17%. Nga përmbushja e indikatorëve individuale nga kjo kategori mund të vërehet se numri më i madh i institucioneve nuk publikojnë asnjë informacion për proceset buxhetore. Ajo që gjithashtu mungon është përgaditja dhe publikimi i buxheteve qytetare që do ju mundësonte qytetarëve informacione të kuptueshme rreth buxhetit dhe do i rriste kapacitetet e qytetarëve për përfshirje më efikase në proceset buxhetore. Në këtë mënyrë do të rriteshin dhe kapacitetet e qytetarëve për të kërkuar llogari dhe përgjegjësi më të lartë gjatë realizimit të buxhetit. Për më tepër, këto janë dhe obligime në kuadër të iniciativës për Partneritet për qeverisje të hapur që duhet të plotësohen me informacione në format të hapur. Publikim i këtyre të dhënave në format të hapur do të mundësonte aplikimin më të mirë të tyre.

Nga ana tjetër, është inkurajues fakti se qytetarët gjithëmon e më shumë besojnë në kapacitetet e tyre për të vlerësuar vendimet e institucioneve që u konstatua nga analiza komparative e anketave të realizuara në periudhë tre vjeçare. Megjithatë, ngelet përshtypja që qytetarët shumë pak i shfrytëzojnë mekanizmat për llogaridhënie dhe përgjegjësi vertikale. Kjo vlen në veçanti për institucionet në nivel lokal ku përfshirja e qytetarëve në proceset e krijimit të politikave do të duhej të ishte më e lartë, duke e patur parasysh faktin se mu aty mund të ndikojnë më shumë.

² Indeksi i qeverisjes së mirë në Maqedoni – ku u mat qeverisja e mirë e institucioneve në nivel qendror dhe hulumtimi LOTOS – ku u mat qeverisja e mirë në nivel lokal.

5. Rekomandime

1. Institucionet duhet ta publikojnë pjesën e vetë të buxhetit për vitin aktual në faqet e tyre të internetit.
2. Institucionet duhet t'i publikojnë raportet financiare vjetore për vitin e kaluar sidhe raportet financiare të gjysmëvjetorit për vitin aktual.
3. Institucionet duhet ta hulumtojnë mendimin e qytetarëve (përmes anketave, konsultimeve, debateve me palët e interesuara) gjatë përgaditjes së propozim-buxhetit që nevojat dhe prioritetet e qytetarëve të merren parasysh në mënyrë më efikase.
4. Institucionet të përgadisnin „buxhet qytetar” për qytetarët jo-ekspert dhe i njehti të publikohet në faqet zyrtare të internetit.
5. Institucionet të shfrytëzojnë evaluim të jashtëm si mjet dhe rezultatet të publikohen në faqet zyrtare të internetit.
6. Institucionet t'i publikojnë raportet e revisionit në faqet e tyre të internetit.
7. Institucionet të publikojnë raporte vjetore për punën e tyre për vitin e kaluar në faqet e tyre të internetit.

PARTNER TË PROJEKTIT

